

**Vendimi**  
i  
**Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë**  
**"ECO RICIKLIM" SHPK**

Sot, më 10/05/2021, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK, regjistruar pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L61814009B në praninë e ortakëve,

- **Z.Adriatik Mema**, i biri i Ferdinandit, lindur në Elbasan, më 21.08.1983 e banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I30821018E, me pjesëmarrje në shoqëri prej 19,00 %;
- **Z.Arber Teqja**, i biri i Ermirit, lindur në Tiranë, më 22.10.1985 banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal I51022034R, me pjesëmarrje në shoqëri prej 51,00 %;
- **Z.Ervin Mece**, i biri i Rasim dhe Thëllëza, lindur në Tiranë, më 13.07.1978 e banues në Tiranë, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal H80713067P, me pjesëmarrje në shoqëri prej 30,00 %.

**ME REND DITE:**

1. Miratimin e kalimit të fitimit të pashpërndarë të vitit 2019 në vlerën prej 34,336,027 (tridhjetë e katër milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë nga fondi i rezervave të tjera në fond për pagimin e dividentit të pashpërndarë për vitin 2019.
2. Miratimin e pagimit të pjesës së mbetur të dividentit të pashpërndarë për vitin 2019 në favor të ortakëve të shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK përpara shitblerjes së kuotës së ish-ortakut Z.Klodian Shehi në favor të ortakut aktual, Z.Arber Teqja, konkretisht:
  - (i) Pagimin e dividentit në vlerën prej 10,300,808.10 lekë (dhjetë milionë e treqind mijë e tetëqind e tetë lekë e dhjetë qindarka) në favor të ortakut Ervin Meçe, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 30% të kuotave të shoqërisë;
  - (ii) Pagimin e dividentit në vlerën prej 17,511,373.77 lekë (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre lekë e shtatëdhjetë e shtatë qindarka) në favor të ish-ortakut Klodian Shehi, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 51% të kuotave të shoqërisë;
  - (iii) Pagimin e dividentit në vlerën prej 6,523,845.13 (gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e pesë lekë e trembëdhjetë qindarka) lekë në favor të ortakut Adriatik Mema, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 19% të kuotave të shoqërisë.
3. Miratimin e kryerjes së pagesës në llogaritë e përzgjedhura nga përfituesit e dividentit, përcaktuar sipas pikës 2 më sipër të këtij Vendimi.
4. Autorizimin e administratorit të shoqërisë Z.Ervin Mece, si dhe çdo personi tjetër të autorizuar prej tij, të përfaqësojë shoqërinë "ECO RICIKLIM" SHPK, me tagra të plota dhe të pakufizuara depozitim i këtij vendimi pranë QKB dhe organeve respektive tatimore, si dhe nënshkrimin dhe

depozitimin e çdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm për realizimin e sa miratuar në pikat 1 deri në 3 si më sipër të këtij Vendimi.

Bazuar në nenin 81/3 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), si dhe Statutin e shoqërisë, pasi Ortakët e shoqërisë

#### KONSTATUAN SE:

Shoqëria "ECO RICIKLIM" SHPK, e regjistruar prane Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L61814009B ushtron aktivitet në: "pastrim, grumbullim, përpunim, transport dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore apo mbetjeve të tjera të ngjashme, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligje. ImportExport dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve dhe mjeteve që përdoren për transportin, magazinimin, të këtyre lloj mbetjesh etj.".

Me Vendimin nr.03, datë 30.06.2020, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK, e përbërë nga Z.Ervin Meçe, Z.Klodian Shehi dhe Z.Adriatik Mema, vendosi miratimin e pasqyrave financiare vjetore 2019 dhe miratimin e fitimit të pashpërndarë të vitit finanziar 2019 në vlerën 34,336,027 (tridhjetë e katër milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë duke e kaluar si "rezerva të tjera" deri në një vendim të dytë.

Me Vendimin datë 29.12.2020, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK, e përbërë nga Z.Ervin Meçe, Z.Klodian Shehi dhe Z.Adriatik Mema ka dhënë pëlqimin paraprak për blerjen nga Z.Arbër Teqja të Kuotës që ortaku Klodian Shehi zotëronte në kapitalin bazë të shoqërisë, kundrejt shumës prej EUR 5,000 (pesëmijë euro). Kështu, në shoqëri u shtua ortaku Arbër Teqja dhe u hoq ortaku Klodian Shehi.

Duke qenë se shoqëria po paguar vetëm një pjesë të dividentit për vitin 2019, në marrëveshje me ortakët Ervin Meçe dhe Adriatik Mema, si dhe ish-ortakun Klodian Shehi, shoqëria ka vendosur të paguajë pjesën e pashpërndarë të dividentit në vlerën e cituar më sipër në llogarinë bankare të përzgjedhura nga vetë përfituesit e dividentit, duke likuiduar kështu pjesërisht dividentin për vitin 2019.

Për këtë qëllim, është i nevojshëm kalimi i vlerës prej 34,336,027 lekë nga fondi "rezerva të tjera" në fond për pagimin e dividentit të pashpërndarë.

Duke qenë se sa më sipër është në përbushje të të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë dhe ortakëve të saj, bazuar në legjislacionin tregtar, si dhe duke qenë se është në përputhje me vullnetin e shoqërisë,

Ortakët e shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK, pas diskutimit të rendit të ditës, unanimisht

#### VENDOSËN:

1. Miratimin e kalimit të fitimit të pashpërndarë të vitit 2019 në vlerën prej 34,336,027 (tridhjetë e katër milionë e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë nga fondi i rezervave të tjera në fond për pagimin e dividentit të pashpërndarë për vitin 2019.
2. Miratimin e pagimit të pjesor të dividentit të pashpërndarë për vitin 2019 në favor të ortakëve të shoqërisë "ECO RICIKLIM" SHPK përpara shitblerjes së kuotës së ish-ortakut Z.Klodian Shehi në favor të ortakut aktual, Z.Arbër Teqja, konkretisht:

- (iv) Pagimin e dividentit në vlerën prej 10,300,808.10 lekë (dhjetë milionë e treqind mijë e tetëqind e tetë lekë e dhjetë qindarka) në favor të ortakut Ervin Meçe, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 30% të kuotave të shoqërisë;
- (v) Pagimin e dividentit në vlerën prej 17,511,373.77 lekë (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre lekë e shtatëdhjetë e shtatë qindarka) në favor të ish-ortakut Klodian Shehi, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 51% të kuotave të shoqërisë;
- (vi) Pagimin e dividentit në vlerën prej 6,523,845.13 (gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e dyzet e pesë lekë e trembëdhjetë qindarka) lekë në favor të ortakut Adriatik Mema, i cili përpara shitblerjes së kuotës zotëronte 19% të kuotave të shoqërisë.
3. Miratimin e kryerjes së pagesës në llogaritë e përzgjedhura nga përfituesit e dividentit, përcaktuar sipas pikës 2 më sipër të këtij Vendimi.
4. Autorizimin e administratorit të shoqërisë Z. Ervin Meçe, si dhe çdo personi tjetër të autorizuar prej tij, të përfaqësojë shoqërinë "ECO RICIKLIM" SHPK, me tagra të plota dhe të pakufizuara depozitimin e këtij vendimi pranë QKB dhe organeve respektive tatimore, si dhe nënshkrimin dhe depozitimin e çdo dokumentacioni tjetër të nevojshëm për realizimin e sa miratuar në pikat 1 deri në 3 si më sipër të këtij Vendimi.

Z.Arbër TEQJA

ORTAKET:

Z.Adriatik MEMA

Z.Ervin MEÇE

